VENDIM
Nr.37, datë 26.9.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "INTERSIG" SHA PËR VITIN 2004

Në mbështetje të shkronjave "d", "ë", "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 20.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve", nenet 93 dhe 111 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" dhe të ligjit "Për kontabilitetin", pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1.T'i kërkojë shoqërisë së sigurimeve INTERSIG sh.a:

a) Të paraqesë në Autoritet pasqyrat financiare të vitit 2004 sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (IFRS) të shoqëruara me raport auditimi të këtyre pasqyrave financiare të lëshuara nga një shoqëri audituese ndërkombëtare.

b) të krijojë rezervën e sigurisë në shumën 29 013 965 lekë që përbën 1/3 (një të tretën) e fitimit të vitit ushtrimor 2004.

2. Shoqëria e sigurime INTERSIG sh.a. ndalohet të shpërndajë fitim për vitin ushtrimor 2004.

3. Shoqëria e sigurimeve INTERSIG sh.a. të bëjë arkëtimin e paradhënies ndaj znj.Ilda Pitarka në shumën 28 792 100 lekë. Ky arkëtim të realizohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Shoqëria e sigurimeve INTERSIG sh.a. të marrë masa urgjente për uljen e gjendjes së likuiditeteve në arkë. Gjendja e likuiditeteve në arkë të jetë jo më shumë se 5 733 669 lekë që përbën 3% të provigjonit teknik, në përputhje me vendimin të Këshillit të Ministrave nr.268, datë 28.4.2005 "Për përcaktimin e kufijve maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve, për mbulimin e provigjioneve teknike dhe matematike nga shoqëritë e sigurimit".

5. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve INTERSIG sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KESHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe RIBA